

20.1.92

DEKLARATE E QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE PER
NJOHJEN E PAVARESISE SE REPUBLIKAVE TE SLLOVENISE DHE
KROACISE

Duke respektuar te drejten e popujve per vetevendosje, mbështetur ne parimet e misheruara në aktin final te Helsinkit, Karten e Parisit per nje Evrope te Re, dokumentet e tjera te KSBE-se, si dhe ne zbatim te politikës se saj te fqinjësisë se mire, qeveria e Shqipërisë deklaroi se një pavarësi e republikave te Sllovenisë dhe Kroacisë. Veprimet per vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me keto republika do te behen mbi bazen e marrevëshjeve dypaleshe.

Qeveria dhe populli shqiptar pershendet kete ngjarje vendimtare ne historine kombëtare te popujve sllovene e kroate dhe e konsideron ate si nje hap te rëndësishëm per zgjidhjen e krizes jugosllave. Ajo eshte e bindur se krijimi i shteteve te pavarura te Sllovenisë e Kroacisë do te jete nje kontribut për ruajtjen e paqes e stabilitetit ne rajonin e Ballkanit.

Me kete rast qeveria shqiptare deshiron te terheqe vëmendjen e Komunitetit nderkombëtar mbi fatin e tre milion shqiptarëve, popullsia e trete ne ish Jugosllavi pas serbeve dhe kroateve. Ajo u ben thirrje Republikave te porsa njohura te Sllovenisë dhe Kroacisë, si dhe gjithë shteteve te botes qe ne kete proces, te njohin Republikën e pavarur e sovranë te Kosoves, te shpallur nga Kuvendi i saj i ligjshëm, nepermjet Deklarates se Pavarësisë. Qeveria e Kosoves ka afirmuar vullnetin e saj për të pranuar dhe per t'iu permbajtur angazhimeve dhe detyrave te percaktuara nga Komuniteti Evropian si kushte per njohjen zyrtare te republikave jugosllave, qe deshirojne te njihen, siç parashtrohet ne Deklaraten per Jugosllavine, adoptuar ne Takimin e Jashtezakonshëm Ministerial te Komunitetit Evropian ne Bruksel, me 16 dhjetor 1991.

Tirane, me 20 janar 1992